

MANUAL PËR PUNIMIN E DIPLOMËS
MANUAL FOR THE PREPARATION OF THESIS

Prof. Ass. Dr. Milaim Sadiku



UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE
MITROVICË

Korrik 2016

Për paqartësi eventuale, studentët për ndihmë mund t'i drejtohen autorit të këtij manuali në adresën elektronike: milaim.sadiku@umib.net

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
Struktura	7
Faqet paraprake	7
Teksti kryesor	7
Pjesa e referencave	7
Kapitujt	8
Fonti dhe Margjinat	8
Numërimi	9
Ballina-kopertina	9
Modeli i ballinës-kopertina shqip	10
Modeli i ballinës–kopertina anglisht	11
Faqe titulluese (nënshkrimit)	12
Modeli i faqes titulluese (nënshkrimit) shqip	13
Modeli i faqes titulluese (nënshkrimit) anglisht	14
Dedikimi	15
Falënderimi	15
Abstrakti	15
Përmbajtja	15
Lista e Tabelave	16
Lista e Figurave	16
Lista e indeksave-Shkurtesave	16
Organizimi i tekstit në kapituj	17
Figurat dhe Tabelat	18

Barazimet	20
Fusnotat	20
Shkurtesat	20
Njësitë	20
Stili i të shkruarit	20
Shtojca	21
KAPITULLI I	22
Hyrja	22
KAPITULLI II	23
Pjesa teorike	23
KAPITULLI III	24
Metodologjia	24
KAPITULLI IV	25
Diskutimi i rezultateve	25
KAPITULLI V	26
Përfundime	26
Sistemi i citimit dhe referencimi	27
Bibliografia/Referencat	31
Burimet e shfrytëzuara	32
Burimet e cituara	34
SHTOJCA	35

HYRJE

Urime për arritjen tuaj në këtë fazë në programin tuaj akademik!

Për të fituar diplomën e studimeve Master, studentët që ndjekin Programet Master përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale. Punimi i diplomës është një punë kërkimore e cila realizohet në mënyrë individuale dhe të pavarur për një çështje a problem nga fusha përkatëse e cila paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të programit. Studentit synon të demonstrojë aftësitë analitike përkatësisht, aftësitë e tij për të integruar perspektivat teorike me materiale të ndryshme empirike, për të shprehur një qëndrim të caktuar profesional, provon zbatimin e një zgjidhje bazuar në një evidencë empirike, identifikon dhe strukturon probleme të reja, zhvillon zgjidhjen e një problemi ose prezanton ide dhe teori të reja.

Tema duhet të jetë punë origjinale e studentit. Gjatë përgatitjes së punimit të diplomës kandidati duhet të bashkëpunojë ngushtë me udhëheqësin e tij. Punimi i temës shkruhet në gjuhën shqipe. Teksti i punimit duhet të jetë në rregull nga pikëpamja gramatikore dhe drejtshkrimore dhe pa gabime shtypi. Tema dorëzohet në 7 (shtatë) kopje të forta në nivelin Master dhe dy kopje elektronike në CD, një për arkivin e fakultetit dhe një për mentorin. Secili anëtar i komisionit duhet të ketë një kopje. Ndërsa në nivelin Bachelor dorëzohen 5 (pesë) kopje. Përgjegjësia për gabimet eventuale në rregullimin e formatit mbetet tek studenti. Tema duhet të printohet vetëm në njërën anë të fletës. Tema duhet të printohet në letër cilësore. Sfondi i kopertinës së punimit duhet të jetë me ngjyrë të kaltër të errët kurse shkronjat ngjyrë ari, për programin e studimeve Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, ndërsa për programin e studimeve Teknologji me specializimet përkatëse, sfondi i kopertinës së punimit duhet të jetë me ngjyrë të kuqe të errët kurse shkronjat ngjyrë ari. Shërbimi administrativ i Fakultetit nuk do të pranojë tema, të cilat nuk i plotësojnë kushtet teknike të paraqitura në këtë manual.

Studenti e mbron temën e masterit (bachelor) me gojë para një komisioni të propozuar nga Komisioni i Studimeve dhe të miratuar nga Këshilli i Fakultetit. Studentit zakonisht i jepet 15-20 minuta kohë për të paraqitur rezultatet e hulumtimit të tij në nivelin Bachelor të studimeve dhe 25-30 minuta në nivelin

Master të studimeve (duke përdorur kompjuterin ose mjete e teknika të tjera sipas nevojës); pastaj, komisioni drejton pyetje. Pyetjet mund të drejtohen dhe nga pjesëmarrësit e tjerë (publiku). Kandidati ka të drejtë të kërkojë pak kohë në mënyrë që të përgatisë përgjigjet (zakonisht deri në 15 minuta). Komisioni i dëgjon përgjigjet dhe jep komentet e tij lidhur me to, ose kërkon shpjegime shtesë. Në parim, nuk mund të bëhen pyetje të çfarëdoshme. Në fund, komisioni tërhiqet për t'u konsultuar për vlerësimin e punimit të shkruar të kandidatit dhe mbrojtjen e bërë prej tij/saj dhe shpall publikisht rezultatin.

Struktura

Punimi Master duhet të përbëhet nga jo më pak se 17 000 përkatësisht dhe jo më shumë se 23 000 fjalët, ose jo më pak se 55 përkatësisht dhe jo më shumë se 80 faqe (përfshirë shënimet, bibliografinë, pjesën shtojcë).

Punimi Bachelor duhet të përbëhet nga jo më pak se 10000 përkatësisht dhe jo më shumë se 15 000 fjalët, ose jo më pak se 32 përkatësisht jo më shumë se 50 faqe (përfshirë shënimet, bibliografinë, pjesën shtojcë).

Tema duhet të jetë organizuar në tri pjesë: pjesën paraprake, pjesën bazë (tekstin kryesor), dhe pjesën e tretë (shtojcën dhe referencat/bibliografinë). Tema duhet të ndahet në kapituj, pjesë dhe nënpjesë. Faqja duhet të jetë e mbushur me tekst nga fillimi deri në fund, me përjashtim të faqes së fundit të kapitullit. Në vazhdim është paraqitur struktura e punimit.

1. Faqet paraprake

- Ballina
- Ballina (Anglisht, nëse punimi është shqip dhe anasjelltas)
- Faqja titulluese (nënshkrimi)
- Faqja titulluese (nënshkrimi)(Anglisht, nëse punimi është shqip dhe anasjelltas)
- Faqja e dedikimit (opsionale)
- Faqja e falënderimit (opsionale)
- Abstrakti
- Abstrakti (Anglisht, nëse punimi është shqip dhe anasjelltas)
- Parathënia (opsionale)
- Përmbajtja
- Lista e Tabelave
- Lista e Figurave
- Lista e Indekseve, Termave, Simboleve, Fjalëve ose Shkurtesave

2. Teksti kryesor

- Studentët përcaktojnë përmbajtjen e brendshme të tekstit, në pajtim me mentorin apo komisionin përkatës. Në vijim është dhënë ndarja sipas kapitujve.

- **KAPITULLI I**
1. Hyrja
- **KAPITULLI II**
2. Pjesa e përgjithshme
- **KAPITULLI III**
3. Metodologjia
- **KAPITULLI IV**
4. Diskutimi i rezultateve
- **KAPITULLI V**
5. Përfundime
Përfundime (Anglisht, nëse punimi është shqip dhe anasjelltas)
3. Pjesa e referencave
- Shtojca/t
- Referencat dhe/ose Bibliografia

Fonti dhe Margjinat

Punimi duhet të jetë i shtypur në letër formati A4 (210 x 297 mm). Faqja mund të ketë më së shumti 2450 shenja dhe nuk duhet të ketë më tepër se 35 rreshta. Fonti (lloji i germave) duhet të jetë Times New Roman dhe madhësia 12 pikë tipografike, kurse hapësira e rreshtave duhet të jetë 1.5 radhë (*1.5 line spacing*). Madhësia minimale në fusnota duhet të jetë 10 pikë tipografike, ndërsa në simbole duhet të jetë 12 pikë tipografike. Margjinat definoohen si hapësira të zbrazëta, që rrethojnë tekstin (Formati i Punimit, Doracak për Studentë, n.d.). Asgjë, duke përfshirë numrin e faqeve, nuk mund të paraqitet në hapësirën e margjinave. Dimensionet e margjinave, ana e majtë duhet të jetë 3,8cm (1.5"), pasi kjo është ana që duhet lidhur, ndërsa ana e djathtë dhe dy anët e tjera: lart, poshtë 2.54 cm (1"). Çdo tabelë apo figurë e paraqitur në temë duhet të përshtatet brenda hapësirës së kufizuar me margjina.

Numërimi

Secila faqe e punimit Master (Bachelor) duhet të ketë një numër. Për faqet paraprake përdoren numrat romakë (i, ii, iii, iv,v, ...). Numërimi fillon me faqen titulluese, si faqe numër i, faqja titulluese në gjuhën angleze faqe ii, por nuk ju shënohen numrat. Vazhdohet me faqen e dedikimit si faqe iii, pastaj me faqen e falënderimit, abstraktit në gjuhën shqipe, abstraktit në gjuhën angleze, parathënia, përmbajtja, lista e tabelave, lista e figurave dhe së fundi lista e indekseve, termave, simboleve, fjalëve ose shkurtesave.

Në tekst duhet të përdoren numrat arab (1, 2, 3, 4,...), duke filluar me faqen 1 (Kapitullin I). Numrat (romak edhe ata arab) duhet të jenë në qendër në pjesën e poshtme të faqes.

Ballina

Titulli i punimit, emri dhe mbiemri i autorit, emri i universitetit, fakultetit dhe departamentit të shkruhen me shkronja të mëdha, 14 pt.

Titulli duhet të jetë sa më përmbajtësor dhe konsistent me përmbajtjen e temës. Titulli nuk duhet të ketë më shumë se 140 karaktere (no spaces). Duhet të formulohet një titull konkret dhe i veçantë për fushën e studimit. Ballina duhet të përmbajë titullin e punimit, gradën shkencore, që arrihet me atë punim, emrin dhe mbiemrin e autorit, stemën e Universitetit, emrin e universitetit, emrin e fakultetit, departamentin, muajin dhe vitin e publikimit. Stema e Universitetit duhet të ketë dimensionet 4x4 cm. Në vijim është paraqitur modeli i ballinës.

Pas ballinës (kopertinës) në gjuhën shqipe vijon faqja e njëjtë, në gjuhën angleze.

Modeli i ballinës/kopertina

TITULLI I PUNIMIT

TEMA PËR GRADËN MASTER (BACHELOR) I SHKENCËS NË
INXHINIERI DHE TEKNOLOGJI USHQIMORE/INXHINIERI E
MBROJTJES SË MJEDISIT

NGA

EMRI MBIEMRI I STUDENTIT



UNIVERSITETI I MITROVICËS „ISA BOLETINI”
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË

MITROVICË

MUAJI DHE VITI

Modeli i ballinës/
kopertina anglisht

TITLE OF THESIS

THESIS FOR THE DEGREE OF MASTER (BACHELOR) OF SCIENCE
IN FOOD ENGINEERING AND TECHNOLOGY/ENVIRONMENT
PROTECTION ENGINEERING

BY

NAME SURNAME OF STUDENT



UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"
FACULTY OF FOOD TECHNOLOGY
DEPARTMENT OF TECHNOLOGY

MITROVICË

MONTH AND YEAR

Faqja titulluese (nënshkrimit)

Faqja titulluese është faqja e parë e punimit. Faqja titulluese është e ngjajshme me ballinën. Titulli i punimit, emri i autorit, emri i universitetit, fakultetit dhe departamentit duhet të jenë me shkronja të mëdha dhe të madhësisë 12pt. Stema duhet të jetë me dimensione 3x3cm. Në vazhdim është dhënë modeli për faqen titulluese.

Pas faqes titulluese në gjuhën shqipe, vijon faqja e njëjtë, në gjuhën angleze.

Faqja titulluese
(nënshkrimit) shqip

TITULLI I PUNIMIT
TEMA E PREZANTUAR

NGA

EMRI MBIEMRI I AUTORIT
BACHELOR I SHKENCËS NË (Shkruhet programi i studimit)

NË

DEPARTAMENTIN E TEKNOLOGJISË

NË PLOTËSIMIN E PJESSHËM TË OBLIGIMEVE PËR TË FITUAR GRADËN
MASTER I SHKENCËS NË INXHINIERI DHE TEKNOLOGJI
USHQIMORE/INXHINIERI E MBROJTJES SË MJEDISIT

MUAJI DHE VITI I KOMPLETIMIT TË TEMËS



UNIVERSITETI I MITROVICËS „ISA BOLETINI”
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË

Aprovuar prej komisionit:

_____ Mentor
Emri Mbiemri, Titulli

_____ Anëtar
Emri Mbiemri, Titulli

_____ Anëtar
Emri Mbiemri, Titulli

Data e aprovimit: _____

Faqja titulluese
(nënshkrimit) anglisht

TITLE OF THESIS
A THESIS PRESENTED

BY

NAME SURNAME OF STUDENT
BACHELOR OF SINCE (In the Study Program)

IN

DEPARTMENT OF TECHNOLOGY

IN PARTIAL FULFILLMENT OF THE REQUIREMENTS FOR THE DEGREE
OF MASTER OF SCIENCE IN FOOD ENGINEERING AND TECHNOLOGY/
ENVIRONMENT PROTECTION ENGINEERING

MONTH AND YEAR



UNIVERISTY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"
FACULTY OF FOOD TECHNOLOGY
DEPARTMENT OF TECHNOLOGY

Approved from Commission:|

_____ Mentor
Name, Surname, Title

_____ Member
Name, Surname, Title

_____ Member
Name, Surname, Title

Date of approval: _____

Dedikimi

Dedikimi është opsional. Nëse shkruhet duhet përdorur shkrim 1.5 radhë dhe të jetë ivendosur vertikalisht dhe horizontalisht. Madhësia e shkronjave duhet të jetë 12 pt, shkrim të pjerrtë (*Italic*). Dedikimi shkruhet në faqe të veçantë. Në faqen, ku fillon dedikimi, së pari lihen 8 zbrazëtira “1.5 spaces” dhe pastaj shkruhet

Shembull i dedikimit është paraqitur në shtojcë.

Falënderimi

Falënderimi është opsional. Punimi është një dokument zyrtar dhe falënderimi duhet të reflektojë të njëjtën shkallë të profesionalizmit. Nëse shkruhet, duhet të jetë një shkrim i thukët dhe jo më i gjatë se një faqe. Shkrimi duhet të jetë 1.5 radhë me madhësi të shkronjave 12pt dhe i pjerrtë (italik). Vetëm personat e përmendur në vazhdim mund të falënderohen: mentori i temës; anëtarët e komisionit të tezës Master apo Bachelor; laborantët, teknikët në laborator; studentët kolegë, të cilët kanë ndihmuar në temë; përkrahsit financiar; si dhe anëtarët e familjes. Falënderimi shkruhet në faqe të veçantë. Në faqen, ku fillon falënderimi, së pari lihen 4 zbrazëtira “1.5 spaces” pastaj fillon teksti i falënderimit.

Shembull i falënderimit është paraqitur në shtojcë.

Abstrakti

Punimi duhet të përmbajë një abstrakt. Tema e hulumtimit paraqitet përmes abstraktit i cili paraqet përkufizimin e problemit. Një abstrakt i punimit Master nuk mund të jetë më i gjatë se 250 fjalë (punimi Bachelor deri 150 fjalë). Abstrakti duhet të përmbajë (1) shtjellimin e problemit, (2) një paraqitje të metodave dhe procedurave të hulumtimit dhe (3) një përmbyllje të rezultateve të fituara. Abstrakti shkruhet në faqe të veçantë.

Abstrakti duhet të shkruhet edhe në gjuhën angleze.

Shembull i abstraktit në gjuhën shqipe dhe angleze është paraqitur në shtojcë.

Përmbajtja

Përmbajtja jo vetëm që jepë informacion rreth strukturës së dokumentit, por gjithashtu ndihmon që të gjenden lehtë titujt e dokumentit. Tek të shkruarit e përmbajtjes, fillimisht lihen 3 hapësira “1.5 spaces” pastaj shkruhet

përmbajtja me shkronja të mëdha. Lihen 2 hapësira “1.5 spaces” dhe shkruhet teksti me kapitujt, titujt dhe nëntitujt. Hapësira e rreshtave në tekst duhet të jetë “1.5 spaces”. Për tituj të gjatë, që vazhdojnë në rreshtin tjetër aplikohet “single space” për hapësirën mes rreshtave. Në mes të tekstit dhe numrave duhet të ketë një zbraçeti 2 cm. Çdo nëntitull, nën-nëntitull, në përmbajtjen e përmbledhur në fillim, duhet të zhvendoset një centimetër djathtas titullit.
Shembull i faqes së përmbajtjes është paraqitur në shtojcë.

Lista e Tabelave

Rregullimi i listës së tabelave është i ngjashëm me atë të përmbajtjes. Lihen tri hapësira “1.5 spaces” shënohet titulli ”LISTA E TABELAVE”, lihen dy hapësira “1.5 spaces” dhe shkruhet tabela përkatësisht përshkrimi i tabelës dhe numri i faqes, ku ndodhet tabela. Në mes të tekstit të tabelës dhe numrit ku tregon faqen lihet një hapësirë 2 cm.

Shembull i faqes të Listës së Tabelave është paraqitur në shtojcë.

Lista e Figurave

Lista e figurave është e ngjashëm me atë të tabelave. Lihen tri hapësira “1.5 spaces” shënohet titulli ”LISTA E FIGURAVE”, lihen dy hapësira “1.5 spaces” dhe shkruhet figura përkatësisht përshkrimi i figurës dhe numri i faqes, ku ndodhet figura. Në mes të tekstit të figurës dhe numrit ku tregon faqen lihet një hapësirë 2cm.

Shembull i faqes të Listës së Figurave është paraqitur në shtojcë.

Lista e indekseve (trguesëve)-Shkurtesave

Lista e indekseve (trguesëve) është e ngjashëm me atë të tabelave dhe figurave. Lihen tri hapësira “1.5 spaces” shënohet titulli ”LISTA E INDEKSEVE”, lihen dy hapësira “1.5 spaces” dhe vazhdohet me simbolin e indeksit, lihet një hapësirë dhe shënohet përshkrimi i indeksit.

Shembull i faqes të Listës së indekseve-shkurtesave është paraqitur në shtojcë.

Organizimi i tekstit në kapituj

Tema duhet të organizohet në kapituj. Përmbajtja e temës do të caktohet nga studenti në bashkëpunim me mentorin. Organizimi i tekstit të kapitullit, si dhe titujve dhe nëntitujve në kapitull duhet të rregullohet në mënyrë standarde për të gjithë kapitujt. Në faqen, ku fillon kapitulli, së pari lihen tri zbrazëtira “1.5 spaces” dhe pastaj shkruhet teksti KAPITULLI dhe numri i kapitullit. Numri i kapitullit shënohet me numër romak. Lihen dyhapësira “1.5 space” dhe shënohet titulli i kapitullit. Lihen prapë dy zbrazëtira “1.5 spaces” dhe pastaj fillohet me tekstin, apo titullin e nivelit të parë. Teksti i kapitullit dhe titullit të kapitullit shkruhet me shkronja të mëdha, 12pt. Teksti i titullit dhe kapitulli duhet të jetë bold (shkrim i trashuar), i rreshtuar në mes. Në temë nuk duhet të ketë më shumë se tri nivele të nëntitujve. Nëntitujt duhet të jenë të rregulluar me numra. Titulli i nivelit të parë vendoset në mes dhe shkruhet me shkronja të mëdha. Titulli i nivelit të parë pas titullit të kapitullit (nëntitull) vendoset në anën e majtë i zhvendosur për një hapësirë (Tab, 0.5 në vizore të monitorit) nga e djathta. Titulli i nivelit të dytë pas titullit të kapitullit po ashtu vendoset në anën e majtë por është i zhvendosur për një hapësirë (Tab, 0.5 në vizore të monitorit) në të djathtë. Teksti i titujve të nivelit të parë dhe të dytë pas titullit të kapitullit duhet të jetë me bold, ndërsa madhësia e shkronjave 12 pt, dhe shkruhen me shkronja të vogla. Titulli i nivelit të tretë pas titullit të kapitullit është i ngjashëm me atë të nivelit të dytë, por teksti vazhdon menjëherë pas titullit; pra, titulli është pjesë e paragrafit por i selektuar (bold). Në fund të titullit vendoset pika.

Titujt nuk mund të paraqiten si rreshta të fundit në një faqe. Ata duhet të jenë të shoqëruar së paku me tre rreshta të tekstit. Nëse një titull mbetet në fund të faqes, ai duhet të zhvendoset në faqen tjetër. Kur një titull ndodhet në kreun e faqes, nuk duhet të lihet hapësirë në mes të margjinës së sipërme dhe titullit. Gjithashtu, nuk duhet të ketë hapësirë në mes të margjinës së sipërme dhe tekstit të faqes. Nëse rreshti i parë i një paragrafi paraqitet në fund të faqes, duhet të zhvendoset në faqen në vazhdim (Formati i Punimit, n.d., f. 14). Hapësira në mes rreshtit të fundit nga teksti paraprak dhe titullit të ri duhet të jetë dy “1.5 spaces”. Hapësira në mes të titullit dhe tekstit duhet të jetë e njëjtë sikurse hapësira në mes rreshtave në tekst.


Shembull se si shkruhen titujt është paraqitur në shtojcë.

Figurat dhe Tabelat


Të gjitha figurat (fotografitë, hartat, vizatimet, skemat, diagramet, etj.) dhe tabelat duhet të kenë emërtimet dhe numrin rendor. Numrat dhe emërtimet e figurave duhet të vendosen nën figurë, kurse numrat dhe emërtimet e tabelave duhet të vendosen mbi tabelë (po aty, f. 16). Madhësia e numrave përkatësisht shkronjave duhet të jetë 11 pt. Numërimi i figurave dhe tabelave bëhet sipas kapitujve. Shembull, Figura: 2.1. Numri i parë tregon kapitullin kurse i dyti radhitjen. Figurat apo tabelat nuk kanë kuptim në një dokument (temë Master apo Bachelor), nëse ato nuk përdoren si referime gjatë përshkrimeve të ngjarjeve apo fenomeneve të caktuara. Figura apo tabela duhet patjetër të përmendet në tekst paraprakisht. Preferohet, që figura të mos jetë shumë larg nga teksti, ku është përmendur; pra, në të njëjtën faqe apo një faqe më poshtë. Nuk preferohet, që figura apo tabela të jetë në mes të tekstit. Nëse është më e vogël se gjysma e faqes, ajo duhet të jetë në pjesën e sipërme apo pjesën e poshtme të faqes. Figurat dhe tabelat duhet të vendosen në mes të faqes, nënkupto hapësira në mes margjinave dhe figurës përkatësisht tabelës duhet të jetë e njëjtë. Nëse figura vendoset në pjesën e sipërme të faqes, nën figurë duhet të lihet një hapësirë “single space” pastaj të shkruhet përshkrimi i figurës, të lihen dy hapësira “1.5 space” dhe të vazhdohet me tekstin, *shembull Figura 4.1 në shtojcë*. Nëse figura vendoset në pjesën e poshtme të faqes, në mes të figurës dhe tekstit lihen dy hapësira “1.5 space”, pastaj nën figurë lihet një hapësirë “single space” dhe pastaj shkruhet përshkrimi i figurës. Përshkrimi i figurës duhet të jetë tek margjina e poshtme e faqes; pra, nuk preferohet të lihet hapësirë në mes të margjinës dhe tekstit të figurës, *shembull Figura 4.2 në shtojcë*. Nëse vendosen dy figura në një faqe, në mes të tekstit të përshkrimit të figurës dhe figurës tjetër duhet të lihen dy hapësira “1.5 space”. Nëse figura është më e madhe se gjysma e faqes, ajo duhet të jetë e vetmuar në faqe, duke e rregulluar, që të mbulojë tërë faqen. Edhe rregullimi i tabelave bëhet ngjashëm sikurse figurat, me përjashtim që përshkrimi i tabelës është në krye të tabelës. Në rastin, kur tabela është më e madhe se gjysma e faqes, ajo mbetet e tillë (po aty). Në rast se figura nuk është kontribut origjinal i autorit të punimit, është obligative të shkruhet burimi. Burimi shënohet nën figurë, në vazhdim të tekstit që përshkruan figurën, por futet në kllapa të vogla.

Barazimet

Barazimet e ndryshme, qofshin matematikore ose reaksione kimike duhet të shkruhen me anë të editorit të formulave, Microsoft Ekuacionet 3.0 si vegël barazimi. Pra, mos të kopjoni dhe ngjisni karaktere nga burimet e jashtme. Ekuacionet matematikore dhe formulat kimike duhet të shkruhen në anën e majtë të faqes, të larguara nga margjina me një Tab, përkatësisht 0.5 në vizoren e kompjuterit. Secila prej tyre duhet të përmbajë numrin e kapitullit dhe numrin rendor në anën e djathtë. Nuk duhet të lihet hapësirë në mes ekuacioneve. Rruga që duhet të ndiqet për shkrimin e barazimeve është dhënë në vijim. Pasi të shtypet OK hapet faqja me “vegla” të cilat shfrytëzohen sipas nevojës.



$$r = r_{\max} \frac{S}{K_m + S} \quad (2.1)$$



Fusnotat

Fusnotat nuk duhet të përdoren shpesh. Fusnotat vendosen për të shtuar ndonjë rikujtim ose vërejtje interesante tekstit të shkruar. Fusnota nuk duhet të kalojë çerekun e faqës, përndryshe në vend të fusnotës do të duhej të vendoset një tekst në vazhdim (Udhëzues, n.d., f. 14).

Shënimi i saktë i fusnotës duhet të ketë të paktën 6 elemente dhe pikën në fund (nëse është tekst i shtypur): 1. Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve; 2. Titulli; 3. Vendi i botimit; 4. Botuesi; 5. Viti i botimit dhe 6. Numri i faqes.

Shembull i përdorimit të fusnotës është paraqitur në shtojcë.

Shkurtesat

Shkurtesat duhet të shkruhen dhe të shpjegohen kur të përdoren për herë të parë. Nëse përdoren shumë shkurtesa, ato duhet të ipen në faqe të veçantë me shpjegimet përkatëse.

Shembull i shkrimit të shkurtesave është paraqitur në shtojcë.

Njësitë

Për shkak të përdorimit të shpeshtë të njësive në dokumentet teknike dhe shkencore, shkrimi i drejt i tyre është me rëndësi. Njësia dhe vlera aktuale ndahet me një zbrazëtirë (p.sh. 178 kJ). Nëse numri është më i vogël se një, një zero duhet të shkruhet (p.sh. 0,1). Numrat shumë të mëdhenj duhet të ndahen me një hapsirë, pa përdorur pikë ose presje (p.sh. 10 000). Vlerat dhe njësitë nuk duhet të jenë në dy rreshta të ndryshëm.

Stili i të shkruarit

Gjatë të shkruarit të punimit, gjithnjë duhet përdorur formën pasive me përjashtim vetëm nëse shkruani ndonjë raport laboratorik. Në ato raporte është e mundur të shkruani fjalët si: “Ne kemi përsëritur eksperimentin pesë herë”. Pra, duhet shmangur shprehjeve “Ne” dhe “unë”. Mos përdorë fjali shumë të gjata dhe shmanguni shpjegimit të ngatërruar.

Shkruani mundësisht shkurt dhe çartë. Në tabelën 1 janë dhënë shembuj për gabimet që bëhen duke përdorur hapësira të zbrazëta sidomos pikat (.,?!). (Udhëzues, n.d. f.14).

Tabela 1: Gabim gjatë përdorimit të zbrazëtirave.

Gabim	Në rregull
(2016)	(2016)
5 %	5%
P. sh.	p.sh.
3-6	3 deri 6
...përgjithësi ,hyrja jep...	...përgjithësi, hyrja jep...
...në punim.Megjithatë...	...në punim. Megjithatë...
<i>...hyrje – dalje...</i>	<i>...hyrje-dalje...</i>

Shtojca

Kur tema përmban shtojcë, në një faqe të veçantë duhet të centrohet titulli shtojcë me shkronja të mëdha përcjellëse. Nëse është vetëm një shtojcë e bashkëngjitur në temë, ajo do të emërohet SHTOJCA pa “A”. Nëse ka më shumë ato emërohen SHTOJCA A, SHTOJCA B dhe kështu me radhë. Materiali i paraqitur në shtojcë duhet të përshtatet brenda margjinave.

KAPITULLI I

1. HYRJA

Hyrja jep informacionin bazë rreth të gjitha pikave të nevojshme që të kuptohet puna e mëvonshme. Pjesa kryesore e hyrjes është përshkrimi i problemit. Kandidati që e shkruan punimin duhet të ketë parasyshë që lexuesit s'janë të familjarizuar me temën e punuar. Nuk duhet shkruar shumë rreth detajeve të dokumentit në punim. Megjithatë, hyrja duhet të jep aq informata sa janë të nevojshme që të përcillen mendimet e autorit rreth zgjidhjes së problemit. Mënyra më e mirë që të fillohet hyrja është që të shkruhet rreth temës që ka lidhje me punimin e autorit.

Në hyrje përshkruhet motivimi i autorit: A është puna e autorit e lidhur me një projekt?

Pse punohet në këtë fushë dhe veçanërisht pse ia vlen të punohet në temën e caktuar?

- Ku është sfida, çka ka të re?
- Cili është kontributi i autorit në këtë punim?
- Si duhet të zgjidhet problemi?
- Cilat probleme duhet të zgjidhen?

Në hyrje është me rëndësi që të definohet dhe të përshkruhen disa qëllime të punës në punim që të shtohet interesimi i lexuesit. Kështu lexuesi do të jetë i interesuar se si mund të zgjidhen problemet dhe si arrihen qëllimet e definuara. Në fund të dokumentit duhet të cekën në mënyrë të qartë se qëllimet e autorit janë arritur. Është një ide e mirë që të fillohet në hyrje me një analizim të problemit, kjo ndihmon lexuesin që të kuptojë autorin më lehtë. Kështu vazhdohet me diskutimin e secilës pikë të punës hap pas hapi dhe duke përfunduar me një përmbledhje në fund të dokumentit. Gjatë shkrimit të dokumentit, autori duhet të përqendrohet në detyrat kryesore të punës së tij dhe të largohet dhënjes së tepërmi të detaleve të informacioneve, në mënyrë që lexuesi të mos jetë i konfuzuar. Të gjitha shkurtesat, konceptet dhe metodat e nevojshme më vonë në punim duhet të shpjegohen në hyrje. Megjithatë hyrja nuk duhet të jep tepër shumë informacione. Aty vetëm përmenden fjalët e rëndësishme të kapitujve paues (Udhëzues, n.d.,f. 7).

KAPITULLI II

2. PJESA TEORIKE

Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej një baze teorike që është mbizotëruese në një fushë të caktuar shkencore. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të përmendet literatura dhe studimet që lidhen me temën Master (Bachelor) të autorëve të tjerë duke u përqendruar kryesisht në rezultatet dhe përfundimet e tyre. Hulumtimet më të reja duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati duhet të bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën përkatëse të hulumtimit (në lidhje me temën apo problemin që dëshiron të shtjellojë) dhe çfarë nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje. Një nga kërkesat kryesore të kësaj pjese është përshkrimi i sfondit teorik. Kapitulli duhet të përfshijë analizën e literaturës së përzgjedhur, për shembull: një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në fushën e caktuar, citime të rëndësishme, etj. Po ashtu, duhet bërë e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për hulumtimin e planifikuar (Manual për Punimin e Diplomës Master, n.d., f15).

KAPITULLI III

3. METODOLOGJIA

Në nivelin e masterit, kërkohet të paraqiten pyetje kërkimore më sfiduese dhe, si rrjedhojë, duhet të zbatohen metodologji më të sofistikuara. Ndonjëherë, përveç bashkëpunimit të ngushtë me udhëheqësin, rekomandohet bashkëpunimi edhe me ekspertë të tjerë.

Para së gjithash kandidati duhet të përkufizojë llojin e qasjes kërkimore për problemin e zgjedhur. Në rastet kur tema e kërkimit është kryesisht teorike dhe nuk kërkon metodologji empirike, ky kapitull përfshin zakonisht këto elemente:

- Grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit (literaturës, dokumenteve, fotografive, etj.);
- Përshkrimin e materialit të grumbulluar (theksi vihet në idetë, format, historinë, etj.);
- Metodatat që do të zbatohen (krahasuese, fenomenologjike, etj.);

Në rastet kur tema e hulumtimit kërkon *metodologji empirike*, ajo përfshin elemente të tilla, si p.sh., një përshkrim të kampionit të përzgjedhur, instrumentet e matjes, procedurat e mbledhjes së të dhënave, përpunim statistikor, etj. Rekomandohet që kjo pjesë të përbëhet nga disa paragrafë, p.sh:

- Kampioni: çfarë lloj kampioni do të përdoret; karakteristikat dhe parametrat kryesorë;
- Instrumentet matës: kush i ka zhvilluar ato dhe kur; karakteristikat, vlerësimi;
- Procedurat dhe kushtet e mbledhjes së të dhënave; metodat e përdorura;
- Përpunimi statistikor (përse; cilat hipoteza do të vërtetohen, etj.) (Manual për Punimin e Diplomës Master, n. d., f. 17).

Rezultatet e fituara prej matjeve paraqiten në tabela dhe në diagrame por nuk diskutohen.

KAPITULLI IV

4. DISKUTIMI I REZULTATEVE

Ky kapitull përmban një rishikim të punës së autorit dhe diskutimi rreth përparësive dhe dobësive të rezultateve të prezantuara në pjesën kryesore. Qëllimi i punës dhe rezultateve është që rezultatet të krahasohen dhe të diskutohen. A plotësojnë rezultatet e punimit, kërkesat e përmendura në fillim? Nëse jo, një shpjegim duhet të jepet, për më tepër autori shkruan opinionin e vetë rreth punës.

Diskutimi është si pjesë më e rëndësishme në tema të diplomës. Se si integrohet diskutimi në dokumentin e punimit të caktuar varet edhe nga problemi i cili është trajtuar në temë (Udhëzues, n. d. f. 8).

KAPITULLI V

5. PËRFUNDIME

Përfundimet prezantojnë një përmbledhje të punës në dokument nga një pikëvërtim tjetër. Në përfundime nuk vendoset diskutimi i rezultateve. Në këtë kapitull shpjegohen vetëm pikat kryesore të cilat përfshijnë përgjigjet në pyetjet:

- Çfarë ka të re nga ky punim për autorin dhe për audiencën?
- Cilat përfundime mund të nxirren nga punimi?
- Cilat eksperiencë janë bërë gjatë punës?
- A ekziston ndonjë rrugë tjetër rreth zgjidhjes së problemit?

Në përfundime duhet të tregohet së qëllimi i punimit është plotësuar. Vërtetimi duhet të bazohet në vlera të matshme, argumente që plotësohen nga puna. Është e qartë që jo të gjithë argumentet duhet të përmenden sërish, por vetëm ata më të rëndësishmit. Në këtë pjesë të dokumentit, duhet të përmenden idetë të cilat mund të përdoren për punë të mëtejme (po aty).

Përfundimet duhet të shkruhet edhe në gjuhën angleze.

Sistemi i citimit dhe referencimi

